



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

QENDRA E KUJDESIT DITOR PËR FËMIJË DHE TË RINJ ME AFTËSI TË KUFIZUARA

TIPOLOGJIA E SHËRBIMEVE TË OFRUARA NË QENDRËN DITORE PËR FËMIJË DHE TË RINJ ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Qendra e Kujdesit Ditor, e ngritur pranë Qendrës së Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara, me adresë: lagjia: “Pavarësia”, Skelë, Vlorë, do të qëndrojë e hapur dhe funksionale në orarin 7:30 – 16:30 dhe do të ofrojë një paketë të plotë shërbimesh për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, të cilat përfshijnë:

- kujdes për ditën e plotë ose gjysmë dite (pas përfundimit të procesit mësimor);
- shërbim psikologjik;
- shërbim shëndetësor;
- logopedi;
- terapi zhvillimi;
- fizioterapi;
- aktivitete okupacionale dhe terapi arti.

Për të rinj madhor deri në 21 vjeç, do të ofrohen shërbime të specializuara me orë, të përshtatura sipas nevojave të identifikuara.

Përfitues të shërbimeve do të jenë edhe për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët do të marrin shërbimet si më poshtë:

- mbështetje psikologjike;
- sesione informimi për prindërimin pozitiv;
- psikoterapi në grup.

Kategoritë që mbulon ky shërbim janë:

1. **Fëmijë me aftësi të kufizuara, në moshë shkollore (6-17 vjeç)**, të cilët do të marrin shërbime me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në Qendrën e Kujdesit Ditor. Shërbimet përfshijnë: terapi zhvillimi, fizioterapi, logopedi, këshillim dhe asistencë psikologjike, aktivitete okupacionale dhe terapi arti. Për prindërit do të ofrohet mundësia për t'i sjellë fëmijët e tyre në Qendër në orën 07:30 të mëngjesit ose pas shkollës, ku ata mund të qëndrojnë deri në orën 16:30.

2. **Të rinj me aftësi të kufizuara, të moshës 18-21 vjeç**, të cilët do të marrin shërbime të specializuara me orë, të përshtatura sipas nevojave të tyre të cilat përfshijnë: terapi zhvillimi, fizioterapi, logopedi, këshillim dhe asistencë psikologjike, aktivitete okupacionale dhe terapi arti.
3. **Prindërit e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara** do të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse të ofruara në Qendër, si: psikoterapi në grup, sesione informimi mbi prindërimin pozitiv, mbështetje psikologjike.

Për ngritjen e Qendrës Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara, Bashkia Vlorë do të mbështetet nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH), në kuadër të programit “BE për Kujdesin Social”, financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga UNICEF Shqipëri dhe World Vision Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.